




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Skupština Opština
Municipality of Assambly

01-Nr. 464-18030/2018
Kaçanik, 06.06.2018

Në mbështetje të nenit 4, paragrafi 2.4.3.6 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e pronës së palujtshme, të ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-205 të nenit 58 Ligji 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e republikës së Kosovës" nr.28/15 Qershor 2008), nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, kërkesës për Shpronësim të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, në cilësi të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut, më datë 06.06.2018, merr:

V E N D I M

I. MIRATOHET kërkesa për iniciimin e procedurës për shqyrtim të metejshëm e Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit për shpronësim të pronës së palujtshme dhe atë: parcela kadastrale **nr.00246-2, me culture mal I kl.2, me sipërfaqe prej 0.37.88 ha**, Zona Kadastrale Soponicë, në emër të **Esat Xhemal Guri nga f.Nikaj** e cila ndërlidhet me projektin për ndërtimin e Vorrezave të Dëshmorëve të Kaçanikut..

2.Vlera e kompenzimit të pasurisë së palujtshme të theksuara më lartë do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përfitojnë pronarët dhe zotëruesit e interesit, të cilët preken nga procesi i shpronësimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës. Komisioni I vlerësimit do të kompenzohet nga ana e Komunës së Kaçanikut.

3.Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesohet: kryetari I Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.

4.Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet: Kryetari,
DUKMM
Drejtoria për Ekonomi dhe Financa,
Arkivi i Komunës dhe Web.faqën e Komunës.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Kryetari i Komunës
01.Nr. 104/02-182/2/2018
Kaçanik, 07.06.2018

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 38 të Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032, nenit 30 të Ligjit për Shërbimin Civil Nr.03/L-149, si dhe në bazë të nenit 2 pika 8 të U.A 08/2014 Procedurat e zgjedhjes së drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit edukativo – arsimor dhe aftësues, Kryetari i Komunës , merr këtë:

V E N D I M

1. z. Osman Krasniqi, emërohet Ushtrues i Detyrës së Drejtorit në SHFMU “Qamil Ilazi” Kaçanik i Vjetër.
2. Detyrën e Drejtorit të SHFMU “Qamil Ilazi” Kaçanik i Vjetër do ta ushtroj prej datës 07.06.2018, deri në plotësimin e këtij vendi të punës apo marrjen e ndonjë vendimi tjetër .
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset : Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Arsyetim:

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës ka shpallur konkurs më datën 14.03.2018 për drejtor në SHFMU “Qamil Ilazi” Kaçanik i Vjetër. Mirëpo, pas mbylljes së konkursit dhe shqyrtimit të dokumentacionit nga komisioni përzgjedhës është rekomanduar që të anulohet konkursi, pasi që kandidatët që kishin aplikuar për këtë pozitë nuk i plotësonin kushtet dhe kriteret e konkursit sipas Udhëzimit 08/2014. Prandaj për të plotësuar këtë pozitë të rëndësishme dhe të domosdoshme z. Osman Krasniqi, emërohet Ushtrues i Detyrës së Drejtorit të SHFMU “Qamil Ilazi” Kaçanik i Vjetër, deri në plotësimin e këtij vendi të punës apo marrjen e ndonjë vendimi tjetër. Duke pasur parasysh të gjitha këto që u cekën më lartë si dhe legjislacionin në fuqi është vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e paknaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh prej ditës së pranimit të këtij vendimi në komisionin për zgjedhjen e e ankesave dhe kontesteve tjera .

Me këtë vendim njoftohen:

- z. Osman Krasniqi,
- Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, dhe
- Arkiva.



Kryetari i Komunës;
z. Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

KRYETARI I KOMUNËS
01Nr. 104/02-18178 /2018
Kaçanik; 07.06 .2018

Në bazë të nenit 90 të Ligjit Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 11 pika 2.1 të rregullores Nr.01/2011 për ndërprerjen, pezullimin dhe përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, nenin 22 të Ligjit për pagat dhe nenin 19 të Rregullores Nr.33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime tjera të nëpunësve civil, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Mbi përfundimin e marrëdhënies së punës

1. Nëpunësit civil, z.Ibrahim Gjini i caktuar në punë dhe detyra të punës, Zyrtar Kryesor financiar në kuadër të Drejtorisë për financa, ekonomi dhe zhvillim i përfundon marrëdhënja e punës në këtë detyrë me arritjen e moshës së pensionimit më **20.06.2018**.
2. I lartpërmenduri duhet të gëzojë të drejtën e marrjes së një page mujore në vlerën e pagës së fundit përkatësisht pagës bruto mujore .
- 3.Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Udhëheqësi i personelit dhe DFEZH-ja.
4. Punëtorit i dorëzohet dokumentacioni i tij personal.

A r s y e t i m

z.Ibrahim Gjini, punëtor në Shërbimin Civil Komunal, i radhitur në vendin e punës Zyrtar kryesor financiar, në kuadër të Drejtorisë për financa, ekonomi dhe zhvillim të Komunës së Kaçanikut, më dt.**20.06.2018** arrin moshën gjashtëdhjetë e pesë vjeçare, si moshë mandatore e pensionimit e përcaktuar në Rregulloren Nr.01/2011 për ndërprerjen, pezullimin dhe përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil. Gjithashtu, bazuar në Ligjin për paga dhe Rregulloren Nr.33/2012, i lartpërmenduri duhet të gëzojë marrjen e një page mujore në vlerën e pages së fundit.

Kryetari i komunës, në pajtim të nenit 11 pika 2.1e Rregullores Nr. 01/2011 për ndërprerjen, pezullimin dhe përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil si dhe Rregulloren Nr.33/ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes, Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave të shërbimit Civil Komunal në Kaçanik.

Me këtë vendim njoftohen: punëtori z.Ibrahim Gjini, Udhëheqësi i personelit, DFEZH dhe Arkivi Komunal.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

KRYETARI I KOMUNËS

01Nr. 104/02-18370/18

Kaçanik, 08.06.2018

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit VII të Kontratës 01Nr.104/02-10029/17 si dhe kërkesës të N.P X-Plast, Kryetari i Komunës merr këtë :

V E N D I M

1. Të kthehet si pronë e Komunës së Kaçanikut pjesa e pashfrytëzuar e tokës- parcelës Nr. 5-0 në zonën kadastrale Kaçanik-Kovaçec, nga Kompania e marrë N.P X- Plast sipas kontratës Nr. 01Nr.104/02-10029/17 për shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale të lidhur më 28.03.2017 në mes të Kryetarit të komunës z. Besim Ilazi dhe pronarit të kompanisë në fjalë z.Nexhat Vogliqi.
2. Sipas këtij vendimi Komuna e Kaçanikut i jep për shfrytëzim afatshkurtër N.P X- Plast me pronar Nexhat Vogliqi , lokacionin i cili gjendet në zonën kadastrale Kaçanik-Kovaçec Nr. i parcelës 5-0 në sipërfaqen prej 38 ari e 54 m² për ushtrimin e veprimtarisë së tregut të kafshëve sipas kohëzgjatjes së caktuar në kontratë.
3. Kompania N.P. X-Plast, duhet ta shlyen borgjin sipas nenit III të kontratës 01Nr.104/02-10029/17 për pjesën e shfrytëzuar në sip. prej 38 ari e 54 m² për ushtrimin e veprimtarisë së tregut të kafshëve.
4. Obligohet Drejtoria e bujqësisë, zhvillimit rural dhe pylltarisë dhe Drejtoria për urbanizëm, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit të bëjë ekzekutimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Sipas kontratës 01Nr.104/02-10029/17, Kompania N.P. X-Plast me pronar Nexhat Vogliqin ka marrë në shfrytëzim afatshkurtër pronën komunale- parcelën Nr. 5-0 në. Mirëpo, një pjesë e konsiderueshme e kësaj parcele nuk ka qenë e përshtatshme për shfrytëzim. Gjithashtu nga ana e komunitetit kemi pasur ankesa të mëdha rreth ndarjes së kësaj parcele. Duke pasur parasysh interesin e përgjithshëm të Komunës dhe komunitetit të kësaj ane në veçanti, kërkesat e vazhdueshme nga ana e kontraktuesit për realizimin e parakushteve për shfrytëzimin e kësaj toke sipas kontratës, erdhëm në përfundim për ndryshimin e sipërfaqes së caktuar në nenin II të kontratës 01/104/02-10029/2017. Prandaj duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe nenin VII të kontratës në fjalë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi. Të njoftohen:

-z. Nexhat Vogliqi-pronar i N.P X-Plast
-DBZHRP dhe DUKMM
-Arkiva e komunës



Kryetari i Komunës
Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Kryetari i Komunës
01Nr. 104/2-13556/18
Kaçanik, 18.06.2018

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetqeverisje Lokale, merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR PËRCJELLJEN E FUSHATËS SË KORRJE-SHIRJEVE PËR VITIN 2018 NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

1.Me këtë vendim formohet komisioni Komunal për përcjellje të fushatës së korrje – shirjeve për vitin 2018, në territorin e Komunës së Kaçanikut me këtë përbërje:

- 1.Zekirja Koxha, Zyrtar i Zhvillimit Rural dhe Blegtori
- 2.Bujar Bajra, Zyrtar për emergjencë
- 3.Mustafë Loku, Zyrtar për bujqësi dhe blegtori

2. Komisioni i formuar është i obliguar që ti bëjë përcjelljen e vazhdueshme të fushatës së korrje-shirjeve dhe pas përfundimit të fushatës duhet të hartoj raport me shkrim me të cilin do të njoftoj: Kryetarin e Komunës, MBPZHR-së dhe DBZHRP-së.

3.Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

4.Me këtë Vendim njoftohen : Arkivi i Komunës, DBZHRP-së dhe anëtarët e komisionit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Kryetari i Komunës
01 Nr. 154/02-19536 2018
Kaçanik, 22.06.2018

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 400/01-1823/18, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

- I. Lejohet shuma e mjeteve finaciare në vlerë prej 210,00 euro për hartimin e testeve të garave të diturisë të organizuara më 6 dhe 7 qershor 2018, për nderë të Ditës së Çlirimit të Komunës së Kaçanikut.
- II. U lejohet kompenzimi, secilit, në vlerë prej 30 euro për mësimdhënësve:
 1. Hizer Leka - hartues i testeve nga lënda e Matematikës;
 2. Burim Bunjaku - hartues i testeve të lëndës Gjuhë shipe,
 3. Arbenita Lumi - hartues i testeve të lëndës së Kimisë,
 4. Ekrem Çaka - hartues i testeve të lëndës së Fizikës,
 5. Burbuqe Gashi - hartuese e testeve të lëndës së Biologjisë,
 6. Bardhyl Hoxha - hartues i testeve të lëndës së Historisë dhe
 7. Selim Reka - hartues i testeve të lëndës së Gjeografisë
- III. Mjetet finaciare nga pika 1 e këtij Vendimi do të merren nga programi buxhetor Subvencione dhe Transfere të Drejtorisë së Arsimit e Kulturës.
- IV. Me këtë vendim njoftohen: Mësimdhënësit dhe Arkiva

Kryetari i Komunës
z. Besim Ilazi

